

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit, Halil Zahiri, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësit, A. R., nga f. Përlepnice, Komuna e Gjilanit, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, në Gjilan, sipas të autorizuarit Bardhosh Dalipi, jur. nga Gjilani, për pagesën e të ardhurave personale, në seancën gjyqësore dhe publike të mbajtur më dt.20.02.2015, bie këtë

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkespadija e paditësit A. R., kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, në Gjilan me të cilën ka kërkuar të detyrohet e paditura t ia paguajnë paditësit në emër të dy pagave jubilarë shumë prej 659,38 €, dhe në emër të regresit shumë prej 120,00 €, të gjitha të llogaritura në lartësinë prej gjithësejt 779,38 € me kamat ligjore.

II. Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi, A. R., nga f. Përlepnice, Komuna e Gjilanit, me padinë e ushtruar më dt.16.10.2012, kishte konfirmuar se pas daljes në pension sipas fuqisë së Ligjit, në bazë të Kontratës kolektive, e paditura është e detyruar t ia paguajnë paditësit dy pagav jubilarë, dhe regresin në shumë 779.38 €, duke ellogaritur edhe kamatën ligjore.

Në seancën kryesore të mbajtur më dt.20.02.2015, paditësi A. R., kishte deklaruar se në tërësi mbetej pran padisë-kërkespadije, të ushtruar më dt.16.10.2012, gjykatës i ka kërkuar në tërësi ta aprovoi kërkespadijën si të bazuar dhe të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, në Gjilan t ia paguajnë paditësit në emër të pagave dhe regresit shumë prej gjithësejt 779.38 €, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore.

E paditura Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, në Gjilan, me përgjigje në padi të ushtruar kësaj gjykate, në seancën kryesore kishte deklaruar se në tërësi e kontestoi kërkespadijën si të pabazuar dhe në kundërshtim me Ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke potencuar se Kontrata Kolektive e vitit 2005 e nënshkruar nga përfaqësuesit e Komisionit trepalësh BSKP-ja, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës, tani nuk është në fuqi, kurse e paditura nuk ishte nënshkruese e Kontratës Kolektive, prandaj e paditura nuk ka për detyrë implementoi këtë kontratë dhe nuk mundë ta zbatoi. Lidhur me këtë kontrata Kolektive ishte implementuar nga viti 2005 deri në vitin 2008, e tani kontrata e tillë nuk është në fuqi dhe është e pa zbatueshme.

Palët ndërgjyqëse gjyktës i propozojnë të lexohen dhe administrohen të gjitha provat nga shkresat e lëndës.

Në bazë të nenit 8 të LPK-ës, lexohen dhe administrohen të gjitha provat nga shkresat e lëndës si vijon:

- Lexohet dhe administrohet, aktvendimi 05 Nr.103/10, i dt.26.02.2010, nga DKA, në Gjila. Nga kjo provë gjykata konstatoi se A. R. sipas fuqisë së ligjit i ndërprehet mardhënja e punës dhe pensionohet.

- Lexohet dhe administrohet, vërtetimi nr.78/12,09. i dt.09.07.2012, nga SH.F. „Skenderbeu,, në f. Përlepnice. Nga kjo provë gjykata konstatoi se A. R. i ka pranuar të ardhurat personale në lartësi prej 329,69 €.

- Lexohet dhe administrohet, vërtetimi nr.78/12,09. i dt.09.07.2012, nga SH.F. „Skenderbeu,, në f. Përlepnice. Nga kjo provë gjykata konstatoi përvojën e punës të A. ,, nga f. Përlepnice.

- Lexohet dhe administrohet, Kontrata e punës nr. 1520/02-1, e dt. 19.11.2007. Nga kjo provë gjykata konstatoi se A. R. ishte punëtorë zyrtarë, Drejtor, në SH.F. „Skenderbeu,, në f. Përlepnice.

- Lexohet dhe administrohet kërkesa e ushtruar DKA në Gjilan, më dt.28.08.2012. Nga kjo provë gjykata konstatoi se paditësi i ka kërkuar pagat mujore dhe regresin, në pajtim me Kontratën kolektive.

- Lexohet dhe administrohet përgjigjja në kërkesë e dt.28.08.2012. Nga kjo provë gjykata konstatoi ishte refuzuar kërkesa për pagat mujore dhe një regres.

- Lexohet dhe administrohet ankesa e dt.13.09.2012 drejtuar Kuvendit komunal në Gjilan, komisionit për ankesa. Nga kjo provë gjykata konstatoi se paditësi i pa knaqur me përgjegjen e DKA, në Gjilan, i kishte ushtruar ankesë Kuvendit komunale, Komisionit për ankesa, në Gjilan.

- Lexohet dhe administrohet Vendimi i dr.21.09.2012. për konstatimin e jo kompetencës për vendosjen e çështjes kontestuese.

- Lexohet dhe administrohet ankesa e dr.24.09.2012. Nga kjo provë gjykata konstatoi se paditësi për realizimin e të drejtave të tija, iu ka drejtuar Këshillit të Pavarur mbikyrës për shërbime cilive të Kosovës.

- Lexohet dhe administrohet, Vendimi nr.1955-2 (291) 2012 i dt.03.10.2012 nga Këshilli i pavarur Mbikqyrës. Nga kjo provë gjykata konstatoi se paditësit iu kishte aprovuar pjesërisht ankesa e tijë ashtu që paditësit iu kishte njohur e drejta për realizimi e dy pagave jubilarë.

Palët ndërgjyqëse deklaruan se nuk kishin prova tjera lidhur me çështjen kontestuese, ndërsa në leximin dhe administrimin e provave nuk kishin vërjetje.

Gjykata i ka vlerësuar të gjitha provat në hollësi veç e veç, duke i analizuar në relacionin krahasues deklaratat e palëve ndërgjyqëse, e ka arritur qëndrimin juridik dhe e ka vërtetuar në mënyrë të plotë e të drejtë gjendjen faktike si vijoi:

Se Kërkespadija e paditësit A. R. e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, në Gjilan, nuk ishte e bazuar në dispozita ligjore, ndërsa në bazë të Qëndrimeve-Sugjerimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Kontrata kolektive e nënshkruar nga Oda Ekonomike e Kosovës, në Prishtinë, Bashkësia e Sindikatave të pavaruara të Kosovës në Prishtinë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk është e zbatueshme dhe nuk prodhon efekte juridike, kurse Qëndrimet-sugjerimet e Gjykatës së shkallës më të lart për gjykatat e instancave më të ulta janë të obliguara dhe duhet të implementohen.

Lidhur me kërkesat e punëtorëve të arsimit, në pensionim të cilët pretendojnë duke u thirr në Kontratën kolektive sipas nenit 42,43 dhe 44 se iu takon e drejta për realizimin e kërkesave të tyre, Gjykata Supreme e Kosovës në arsyetimin e sajë ka përfundur se nuk është e zbatueshme Kontrata kolektive dhe është në kundërshtim me dispozitat e nenit 4.1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr.2001/33/ të dt.22.12.2001, mbi pensionet në Kosovë.

Sipas dispozitës së nenit 4.1. citohet „Administrata udhëheq dhe administron pagesën e pensioneve bazë për të gjithë qytetarët me banim të përhershëm në Kosovë, të cilët e arrijnë moshën e pensionimit. Në këtë Rregulloren për pensionet në Kosovë, as kund nuk është konfirmuar dhe përcaktuar e drejta e pensionstëve për realizimin e pagave jubilarë dhe të pagave përcjellëse pas pensionimit apo të regresit.

Lidhur me këtë gjykata themelore në Gjilan, në bazë të aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, sipas fuqisë së Ligjit, në kohën kur Kontrata Kolektive nuk aplikohet se nuk ishte në fuqi edhe pse kontrata e tillë më parë ishte e nënshkruar nga tre subjekt dhe e njejtja më parë zbatohet për një periudhë kohore prej 3 vitesh dhe atë nga viti 2003 deri në fund të vitit 2005, ndërsa paditësi ishte pensionuar në vitin 2010, kur kontrata Kolektive nuk ishte

në fuqi dhe nuk prodhon efekte juridike pozitive që kishte me ndikuar në realizimin e kërkesave të pensionistëve e në rastin konkret paditësit.

Gjykata duke u bazuar në këto fakte, rrethana dhe prova të administruara e ka arritur qëndrimin të sajë juridik dhe në tërësi e ka rrefuzuar kërkespadinë e paditësit si të pa bazuar.

Nga të cekurat më lart në bazë të nenit 4.1 të Rregullorës mbi pensionet në Kosovës dhe nenit 143 të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv e këtijë aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi që sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari,
Halil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtijë aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7.ditësh, nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes kësaj gjykate.